



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3232 prot.

Tiranë më, 10.12.2019

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 09, datë 10.12.2019

**MBI MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURIALE NË PROKURORITË PËR
KRIME TË RËNDA DHE NË PROKURORITË E SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ME FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
PROKURORISË SË POSAÇME**

Në mbështetje të neneve 148/b shkronja “b”, 135 pika 2 e 179 pika 8¹ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronja “b”, 46 pikat 1, 2, 3 shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 9 e 57 pika 5 të ligjit nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, neneve 160, 162 e 163 të ligjit 96/2016 “Për statutsion e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 28, 75/a, 84, 285 pika 5, “dispozita kalimtare”² e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neneve 3, 7, “dispozita kalimtare”³ e vijues të ligjit nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, si dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese për hetimin e pasurisë” i ndryshuar, neneve 9, 12 e vijues të ligjit nr.8331/1998 “Për

¹ Shih, nenin 179 e Kushtetutës, i cili në pikën 8 parashikon: “8...Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.”;

² Shih, Kodin e Procedurës Penale, “dispozita kalimtare” e shtuar me nenin 285 të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, e cila në pikën 5 parashikon: “5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. i njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.”

³ Shih, nenin 35 “dispozitë kalimtare” të ligjit nr.70/2017 që ka plotësuar ligjin nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, si dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese për hetimin e pasurisë”, në pikën 6 të cilit parashikon: “6. Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar çështjet në hetim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë prokurori dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.”

ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar, nenit 13/1 e vijues të ligjit nr. 8328/1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, vendimin njësuës nr. 13, datë 4.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ligjit nr.9154/2003 “*Për arkivat*”, urdhërit nr.165 datë 24.07.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm, “*Për regjistrat dhe administrimin e tyre në Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm*”, vendimet datë 25.10.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për emërimin e 8 (tetë) prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme⁴;

U D H Ë Z O J:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të normojë dhe unifikojë masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për transferimin e procedimeve/çështjeve në hetim sipas kompetencës lëndore dhe/ose toksore të parashikuar në ligj⁵, me krijimin dhe fillimin e funksionit të Prokurorisë së Posaçme, në zbatim të parimit të ligjshmërisë, për të garantuar si respektimin e të drejtave dhe lirive të personave nën hetim, të pandehurve dhe viktimave të veprave penale, ashtu dhe ruajtjen e sekretit të hetimeve dhe ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale.

Neni 2 Objekti

Objekti i këtij udhëzimi të përgjithshëm është përcaktimi i masave administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm:

a) për identifikimin, administrimin dhe inventarizimin e akteve apo dokumentave, objekt dorëzimi administrative për kompetencë prokurorive kompetente përkatëse, si dhe formën dhe kohën e dorëzimit të tyre;

b) për identifikimin, administrimin dhe inventarizimin e procedimeve apo çështjeve, objekt transferimi për kompetencë lëndore dhe/ose tokësore në prokuroritë kompetente përkatëse, si formën e aktit/eve të vendimarrjes, mënyrën dhe kohën dorëzimit apo dërgimit tyre.

c) për garantimin e lirive dhe të drejtave të personave me masë sigurimi personal “arrest në burg” apo “arrest në shtëpi”, personave nën hetim, të pandehurve dhe/ose viktimave të

⁴ Shih, njoftimin datë 25.11.2019 në fazen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili ka publikuar njoftimin, si për miratimin e akteve për emërimin e 8 (tetë) prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, ashtu dhe se “*Me datë 19 Dhjetor 2019 tetë prokurorë të emëruar në SPAK do të kryejnë betimin para Presidentit të Republikës...Sipas ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 61 pika 2 ...thuhet “Mandati fillon ditën kur bëhet ceremonia e betimit përpara Presidentit të Republikës...”*”.

⁵ Shih, nenin 75/a dhe pikën 5 të dispozitës kalimtare në Kodin e Procedurës Penale, si dhe nenet 3, 6 dhe pikën 6 të dispozitës kalimtare të ligjit nr.10192/2017, të cituara mësipër.

procedimit penal gjatë procedurës së transferimit për kompetencë lëndore dhe/ose tokësore të akteve, procedimeve apo çështjeve në prokuroritë kompetente përkatëse.

ç) për të siguruar ruajtjen e sekretit hetimorë dhe ndalimin e publikimit të akteve, procedimeve apo çështjeve objekt transferimi për kompetencë prokurorive përkatëse.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim termat apo emërtimet kanë kuptimet, si më poshtë:

1. “*Prokurori pranë gjykatave për krime të rënda*” janë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

2. “*Prokurori pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm*” në zbatim të këtij udhëzimi janë Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm.

3. “*Prokuroria e Posaçme*” është prokuroria që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj⁶.

4. “*Dita e krijimit dhe fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme*” është data 19 Dhjetor 2019⁷, në të cilën prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme do të kryejnë betimin para Presidentit të Republikës.

5. “*Procedime/çështje me disponime të gjykatës në fazën e hetimeve paraprake*” në zbatim të këtij udhëzimi janë ato procedime apo çështje penale me persona nën hetim apo të pandehur ndaj të cilëve ka vendimarrje të gjykatës në hetimet paraprake, siç mund të jenë: vendime për caktimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg” apo “arrest në shtëpi”, autorizime për përgjime telekomunikimi apo zgjatje të afateve të tyre, sigurim prove, zgjatje të afatit të hetimeve paraprake apo zgjatje e afatit të paraburgimit ose disponime të tjera të gjykatës në këtë fazë.

KREU II MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

Masat administrative në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda

1. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda sipas fazave të procedimit, pasi të identifikohen dhe rakordohen me regjistrat përkatës, të administrohen dhe inventarizohen aktet apo dokumentat, fashikujt e procedimit/çështjes penale dhe hetimeve pasurore të krijuara dhe/ose të ardhura në atë prokurori, të listuara sipas prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që i kanë në ndjekje, për dorëzimin administrativ dhe/ose transferimin për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme, të grupuara:

a) Në fazën e hetimeve paraprake:

i) Kallëzime penale dhe/ose referime të veprave penale të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit;

⁶ Shih, nenin 4 pika 1 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”

⁷ Shih, shënimin fundor “4”, më sipër.

ii) Procedime penale të regjistruara në fazën e hetimeve paraprake pa disponime me vendim gjykatë në këtë fazë;

iii) Procedime penale të regjistruara me persona nën hetim dhe/ose të pandehur me masë sigurimi personal apo masë sigurimi pasurorë ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit apo me sigurim prove, apo veprime të tjera në këtë fazë të disponuara me vendime gjyqësore.

b) Në fazën e gjykimit, fashikujt me kërkesat e prokurorit dhe aktet proceduriale përkatëse të dërguar në gjykatë:

i) për disponimet në gjykatë në fazën e hetimeve paraprake, me status në pritje për tu shqyrtuar;

ii) për disponime në seancën paraprake me status në pritje për tu shqyrtuar;

iii) për gjykimet e themelit, me status në pritje për të filluar shqyrtimi gjyqësor dhe/ose vazhdimi i gjykimit të themelit nga gjykata kompetente;

iv) për disponime në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe/ose të vuajtjes së dënimit, apo kërkesa të autoriteteve gjyqësore të huaja në fushën penale në këtë fazë, me status në pritje për të filluar shqyrtimi gjyqësor dhe/ose vazhdimi i gjykimit, si mbi kërkesat e prokurorit, ashtu dhe mbi kërkesat e të interesuarit apo mbrojtësit të tij.

c) Në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale:

i) Vendime të formës së prerë të Gjykatave për Krime të Rënda, të pa vëna në ekzekutim.

ii) Kërkesa/nisma të institucioneve ligjzbatuese dërguar drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda, për ti kërkuar Ministrin të Drejtësisë vendosjen e të dënuarve në regjim të posaçëm⁸, të cilat janë me status për verifikim dhe/ose vlerësim.

ç) Hetimet pasurore:

i) Referime apo kërkesa për kryerjen e hetimeve pasurore të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit;

ii) Hetime pasurore të filluara ndaj subjekteve për veprat penale të përcaktuara në ligj⁹ me ose pa sekuestrim të pasurisë me vendime gjyqësore.

d) Gjykimi i hetimeve pasurore:

i) Fashikujt me kërkesat e prokurorit dhe aktet proceduriale përkatëse të dërguar në gjykatë, për sekuestrimin e pasurisë, me status në pritje për tu shqyrtuar;

ii) Fashikujt me kërkesat e prokurorit dhe aktet përkatëse të dërguar në gjykatë, për konfiskim të pasurisë, me status në pritje për të filluar shqyrtimi gjyqësor dhe/ose vazhduar gjykimi i hetimit pasuror nga gjykata kompetente;

dh) Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatave për Krime të Rënda për sekuestrim pasurise ose konfiskim pasurie, të pa vëna në ekzekutim.

e) Letër-kërkesa të ardhura nga autoritet gjyqësore të huaja në fushën penale, të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit.

⁸ Shih, nenin 13/1 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

⁹ Shih, nenet 3, 7, “dispozita kalimtare” të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

2. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, pasi të identifikohen dhe rakordohen me regjistrat përkatës, të administrohen dhe inventarizohen në tërësi aktet apo dokumentat, fashikujt e procedimit/çështjes penale dhe hetimeve pasurore të krijuara dhe/ose të ardhura në atë prokurori, të listuara sipas prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që i kanë në ndjekje, për dërgimin administrativisht dhe/ose transferimin për kompetencë lëndore dhe tokësore në prokuroritë përkatëse pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të grupuara:

a) Në fazën e hetimeve paraprake:

i) Kallëzime penale dhe/ose referime të veprave penale të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit;

ii) Procedime penale të regjistruara në fazën e hetimeve paraprake pa disponime me vendim gjykate në këtë fazë;

iii) Procedime penale të regjistruara me persona nën hetim dhe/ose të pandehur ndaj të cilëve është disponuar me vendime gjyqësore.

b) Hetime pasurore:

i) Referime apo kërkesa për kryerjen e hetimeve pasurore të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit;

ii) Hetime pasurore të filluara ndaj subjekteve përkatës për veprat penale të përcaktuara në ligj¹⁰ me ose pa sekuestrim të pasurisë të disponuar me vendime gjyqësore.

c) Letër-kërkesat e ardhura nga autoritet gjyqësore të huaja në fushën penale në kuadrin e hetimeve pasurore.

Neni 5

Masat administrative në prokuroritë pranë gjykatës së apelit për krime të rënda

1. Në prokurorinë pranë gjykatës së apelit për krime të rënda sipas fazave të gjykimit, pasi të identifikohen dhe rakordohen me regjistrat përkatës, të administrohen dhe inventarizohen në aktet/dokumentat në fashikujt e krijuar nga prokurorët, të listuar sipas prokurorëve që i kanë në ndjekje, objekt dorëzimi administrativ në Prokurorinë e Posaçme, të grupuara:

a) Në fazën e gjykimit të ankimeve kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, fashikujt me ankimet e prokurorit ose ankimet e personit nën hetim apo avokatit të tij dhe/ose të viktimës apo trashigimtarëve të tij, të shpallur për gjykim në atë gjykat dhe në pritje për të filluar shqyrtimi gjyqësor ose vazhdimi i gjykimit:

i) për disponime në gjykatë në fazën e hetimeve paraprake;

ii) për disponime në seancën paraprake;

iii) për gjykime të themelit;

iv) për disponime në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe/ose të vuajtjes së dënimit apo të kërkesave të autoriteteve gjyqësore të huaja në fushën penale.

b) Në fazën e gjykimit të ankimeve kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda për hetimet pasurore, disponime lidhur me sekuestrimin e pasurisë ose konfiskimin e pasurisë.

¹⁰ Shih, shënimin fundor "9" më sipër.

Neni 6

Masat administrative në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në fazën e hetimeve paraprake, pasi të identifikohen dhe rakordohen me regjistrat përkatës, të administrohen dhe inventarizohen aktet apo dokumentat, fashikujt e procedimit apo çështjet e krijuara dhe/ose të ardhura në atë prokurori, objekt dorëzimi administrativ dhe/ose transferimi/kalimi për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme, të grupuara:

- i) Kallëzime penale dhe/ose referime të veprave penale të regjistruara në regjistrin përkatës që janë në fazën e verifikimit;
- ii) Procedime penale të regjistruara në fazën e hetimeve paraprake pa disponime me vendim gjykate në këtë fazë;
- iii) Procedime penale të regjistruara me persona nën hetim dhe/ose të pandehur me masë sigurimi personal apo masë sigurimi pasurorë ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit apo me sigurim prove, të disponuara me vendime gjyqësore.
- iv) Letër-kërkesa të ardhura nga autoritet gjyqësore të huaja në fushën penale.

KREU III

MASAT PROCEDURIALE PENALE

Neni 7

Forma dhe mënyra e procedimit për transferimin e akteve për kompetencë lëndore nga prokuroria e shkallës së parë për krime të rënda në Prokurorinë e Posaçme

1. Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, për aktet, procedimin apo çështjen penale, të regjistruar për vepra penale dhe/ose ndaj subjekteve të listuara¹¹ në nenin 75/a të K.Pr.Penale i ndryshuar, të cilët janë në fazën e hetimeve paraprake, vendosë moskompetencën dhe transferimin¹² e akteve, procedimit/çështjes penale për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme, duke njoftuar gjykatën përkatëse në rastet kur ndaj personit nën hetim ose të pandehurit është disponuar me vendim të gjykatës në këtë fazë.

Neni 8

Forma dhe mënyra e procedimit për transferimin e akteve për kompetencë lëndore e tokësore nga prokuroria e shkallës së parë për krime të rënda në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

1. Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, për aktet, procedimin apo çështjen penale, të regjistruar për vepra penale të listuara¹³ që parashikonte neni 75/a i K.Pr.Penale, të cilët janë në fazën e hetimeve paraprake, vendosë moskompetencën dhe transferimin¹⁴ e akteve, procedimit/çështjes penale për kompetencë lëndore dhe tokësore prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke njoftuar

¹¹ Shih, nën paragrafin katër të paragrafit 43 të vendimit njëses nr.13, datë 04.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (KPGJL).

¹² Shih, piken 5 të “dispozitës kalimtare” dhe nenit 84 të K.Pr.Penale.

¹³ Shih, nën paragrafin pesë të paragrafit 43 të vendimit njëses nr.13, datë 04.04.2018 të KPGJL.

¹⁴ Shih, piken 5 të “dispozitës kalimtare” dhe nenit 84 të K.Pr.Penale

gjykatën përkatëse në rastet kur ndaj personit nën hetim ose të pandehurit është disponuar me vendim të gjykatës në këtë fazë.

Neni 9

Forma dhe mënyra e procedimit për transferimin e akteve për kompetencë lëndore nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme

1. Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, për aktet, procedimin apo çështjen penale, të regjistruar për vepra penale dhe/ose ndaj subjekteve të listuara¹⁵ në nenin të 75/a K.Pr.Penale i ndryshuar, të cilët janë në fazën e hetimeve paraprake, vendosë transferimin¹⁶ e çështjes për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme, duke njoftuar menjëherë gjykatën përkatëse në rastet kur ndaj personit nën hetim ose të pandehurit është disponuar me vendim të gjykatës në këtë fazë.

KREU IV

PROCEDURA E DORËZIMIT ADMINISTRATIV DHE PROCEDURAL TË AKTEVE

Neni 10

Dorëzimi administrativ dhe procedural i akteve nga prokuroritë pranë gjykatave të krimeve të rënda në Prokurorinë e Posaçme

1. Dorëzimi i administrativ dhe procedural penal i akteve, procedime/çështjeve penale, hetimeve pasurore, dokumentave dhe regjistrave përkatës nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe prokuroria pranë gjykatës së apelit për krime të rënda tek Prokuroria e Posaçme kryhet me krijimin dhe fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme.

a) Forma e transferimit të çështjeve/procedimeve penale është me vendim të prokurorit, sipas normimeve në nenin 7 të këtij udhëzimi.

b) Forma e transferimit të çështjeve në hetim pasurorë është me shkresë përcjellëse të drejtuesit të prokurorisë, sipas normimeve në pikën 1 shkronja “ç” dhe pikën 2 shkronja “b” të nenit 4 të këtij udhëzimi.

2. Të gjithë regjistrat dhe librat¹⁷ që pasqyrojnë veprimtarinë në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe në prokurorinë pranë gjykatës së apelit për krime të rënda, pasi të jenë inventarizuar, sekretuar në fund e vulosur dhe firmosur nga personat përgjegjës, mbyllen me dorëzimin, si administrativ të akteve, dokumentave, regjistrave dhe librave përkatës, ashtu dhe me dorëzimin e akteve, procedimeve/çështjeve penale të listuara në Prokurorinë e Posaçme, sipas normimeve në këtë udhëzim.

3. Dorëzimi i akteve, fashikujve të procedimeve apo çështjeve bëhet me procesverbal të rregullt në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi¹⁸. Krahas të dhënave të tjera, në përmbajtjen e procesverbalit ose në aneksin bashkelidhur tij që listohen aktet,

¹⁵ Shih, po aty, nën paragrafin tre.

¹⁶ Shih, pikën 5 të “dispozitës kalimtare” dhe nenit 84 të K.Pr.Penale.

¹⁷ Shih, nenin 2 të urdhërit nr.165 datë 24.07.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrat dhe administrimin e tyre në Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”.

¹⁸ Shih, ligjin nr.9154/2003 “Për arkivat”, dhe nenet 33, 34, 36, 37, 38, 39, 40 e vijues të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.32 datë 31.01.2017 “Për miratimin e Rregullores Standarde të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm”, si dhe Rregulloret e Brendshme të Prokurorive për Krime të Rënda të dala në zbatim të tij.

procedimet/çështjet penale, të pasqyrohen edhe të dhëna për: -numrin/datën e aktit, fashikullit të procedimit apo çështjes, -numrin e personave me masa sigurimi personal “arrest në burg” dhe kohëzgjatja e paraburgimit, -kohëzgjatja e afatit të hetimit procedural.

Neni 11

Dërgimi administrativ dhe procedural penal i akteve nga prokuroria pranë gjykatës për krimeve të rënda në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

1. Dërgimi me shkresë nëpërmjet postës zyrtare të akteve/dokumentave administrativ e hetimeve pasurore të listuar, dhe akteve apo procedimeve/çështjeve penale të listuara nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda tek prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm kryhen:

a) Në formën e moskompetencës dhe transferimit të çështjeve/procedimeve penale me vendim të prokurorit, sipas normimeve në nenin 8 të këtij udhëzimi.

b) Në forma e transferimit të çështjeve në hetim pasurorë të listuara është me shkresë përcjellëse të drejtuesit të prokurorisë, sipas normimeve në pikën 1 shkronja “ç” dhe pikën 2 shkronja “b” të nenin 4 të këtij udhëzimi.

2. Në shkresën përcjellëse, ose në aneksin bashkelidhur shkresës, krahas të dhënave të tjera, të listohen aktet, procedimet/çështjet penale me të dhëna për: -numrin/datën e aktit, fashikullit të procedimit apo çështjes, -numrin e personave me masa sigurimi personal “arrest në burg” dhe kohëzgjatja e paraburgimit, -kohëzgjatja e afatit të hetimit procedural.

Neni 12

Dërgimi administrativ dhe procedural penal i akteve nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme

1. Dërgimi me shkresë nëpërmjet postës zyrtare të akteve/dokumentave administrativ e hetimeve pasurore të listuar, dhe akteve apo procedimeve/çështjeve penale të listuara nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme kryhet në formën e moskompetencës dhe transferimit të çështjeve/procedimeve penale me vendim të prokurorit, sipas normimeve në nenin 8 të këtij udhëzimi.

2. Në shkresën përcjellëse, ose në aneksin bashkelidhur shkresës, krahas të dhënave të tjera, listohen aktet, procedimet/çështjet penale me të dhëna për: -numrin/datën e aktit, fashikullit të procedimit apo çështjes, -numrin e personave me masa sigurimi personal “arrest në burg” dhe kohëzgjatja e paraburgimit, -kohëzgjatja e afatit të hetimit procedural.

KREU IV

GARANTIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË SUBJEKTEVE TË PROCEDIMIT PENALE, RUAJTJA E SEKRETIT TË HETIMEVE DHE NDALIMI I PUBLIKIMIT TË AKTEVE PROCEDURIALE

Neni 13

Garantimi i të drejtave dhe lirive të subjekteve të procedimit penal

Në prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të merren masave e duhura procedurale penale për zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, në garantimin e lirive dhe të drejtave të personave me masë

sigurimi personal, personave nën hetim, të pandehurve dhe/ose viktimave të procedimit penal gjatë periudhës dhe/ose procedurës të kalimit për kompetencë lëndore dhe/ose tokësore të akteve, procedimeve apo çështjeve në prokuroritë kompetente sipas ligjit¹⁹ dhe normimeve në këtë udhëzim të përgjithshëm.

Neni 14

Ruajtja e sekretit hetimorë dhe ndalimi i publikimit të akteve procedurale penale

Në prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të merren masat e duhura administrative dhe procedurale penale²⁰ për të siguruar ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetin e të dhënave hetimore dhe ndalimin e publikimit të akteve, procedimeve apo çështjeve objekt kalimi për kompetencë prokurorive përkatëse, para, gjatë dhe pas dorëzimit në prokuroritë përkatëse kompetente.

KREU VI

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 15

Përgjegjësia disiplinore

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim të përgjithshëm përbën shkelje disiplinore dhe shkak për fillimin e hetimit disiplinor sipas ligjit.

Neni 16

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të të gjithë llojeve dhe niveleve dhe nëpunësit civil e punonjësit e administratës të gjithë niveleve në prokuroritë për krime të rënda, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm²¹.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive për krime të rënda, drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm²² dhe drejtuesit e autorizuar në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme të marrin masat e duhura administrative, financiare e të teknologjisë së informacionit dhe për përgatitjen e akteve përkatëse me pushimin e funksionimit të Prokurorive për Krime të Rënda.

4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm²³.

¹⁹ Shih, nenet 1, 6, 9/a, 34/a, 58 e vijues të K.Pr.Penale.

²⁰ Shih, nenet 103, 104, 279 e vijues të K.Pr.Penale, ligjin nr.8457/1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"" dhe udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3, datë 26.11.2018 "Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror"

²¹ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016.

²² Shih po aty nenin 43 shkronja "dh".

²³ Shih po aty nenet 46 pika 4.

Neni 17

Hyrja në fuqi, afati i zbatimit dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe detyrimet e përcaktuara në të zbatohen brenda datës 19 Dhjetor 2019.

2 Udhëzimi i përgjithshëm të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

